



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

4981/2
Nr. / Prot.

Tiranë, më/19/09/2022

URDHËR

Nr. 453, datë 19/09 2022

**“PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE VËREJTJE ME PARALAJMËRIM PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË NOTERIT DHE GJOBË
NË MASËN 300 000 LEKË PËR NOTERIN [REDACTED]”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr.8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 25, të gërmës “b”, “c”, të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Me Urdhrin nr. 564, datë 13.10.2021 të Ministrit të Drejtësisë është vendosur për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit [REDACTED], bazuar në urdhrin nr. 41, datë 01.02.2021 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të noterëve, për vitin 2021”.

Objekti i këtij inspektimi administrativ ka qenë verifikimi i zbatimit të ligjit nr.110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, ligjit nr. 7829/1994 “Për noterinë” i ndryshuar, (i shfuqizuar), si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, standarteve të sjelljes profesionale, si dhe zbatimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për periudhën 2017-2021 nga ana e noterit [REDACTED]

Në përfundim të kryerjes së inspektimit pranë zyrës së noterit [REDACTED] dhe analizës ligjore të akteve dhe veprimeve noteriale, objekt i kontrollit administrativ, grupi i kontrollit hartoi raportin “Për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publik [REDACTED] në të cilin, janë relatuar gjetjet përkatëse për të cilat vlerësojmë se, lidhur me detyrimin e noterit për hedhjen në sistem të akteve noteriale, në zbatim të VKM-së nr. 304, datë 21.05.2014, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit Noterial Shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)”, rezulton se noteri [REDACTED] ka mangësi në regjistrimin e akteve/veprimeve noteriale në sistemin RNSH lidhur me periudhën objekt inspektimi.

Referuar Urdhrit nr. 88, datë 04.03.2013, i Ministrit të Drejtësisë “Për përdorimin e Regjistrimit Elektronik Noterial Shqiptar (RNSH)”, i cili përcakton qartë detyrimin për noterët që të përdorin regjistrin elektronik noterial për regjistrimin e të gjitha akteve dhe veprimeve noteriale të kryera, duke filluar nga data 15.03.2013, konform vendimit nr. 304, datë 21.05.2014 “Për krijimin e bazës së të

dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH), vlerësojmë se mosregjistrimi të dhënave të plota për çdo çështje noteriale, mosprocedimi i çështjeve në sistemin elektronik brenda afatit (10 ditor) nga ana e noterit përbën shkelje disiplinore në kuptim të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë", i ndryshuar.

Ndërkohë, lidhur me verifikimin e kontratës së sigurimit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, rezulton se noteri [REDAKTUAR] ka respektuar pjesërisht detyrimin e parashikuar në nenin 65, të ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, dhe nenin 25 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", i ndryshuar (i shfuqizuar), pasi nga noteri administrohet vetëm policia e sigurimit për mbulimin e përgjegjësisë profesionale të noterisë me nr. 15/0801/010912 që i përket periudhës 01.06.2021-31.05.2022.

Sa i përket aplikimit të taksës së pullës në aktet/veprimet noteriale në arkivin e noterit rezulton se, nga verifikimi akteve/veprimeve noteriale të zgjedhura rastësisht nga grupi inspektimit, noteri [REDAKTUAR] në disa prej tyre aplikon pjesërisht saktë taksën e pullës. Në këto kushte subjekti i inspektimit ka shkelur detyrimin e parashikuar në nenin 63, gërma 'dh', të ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar.

Gjithashtu, konstatojmë që noteri [REDAKTUAR] të mos ketë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për raportim brenda 24 orëve nga hartimi i aktit në DPPPP, konkretisht për njërin nga aktet noteriale, aktin "Kontratë Shitblerje Pasuri e Paluajtshme", Nr. [REDAKTUAR] Rep, Nr. [REDAKTUAR] Kol., datë 13.10.2017. Vlerësojmë se, një raportim i tillë duhej realizuar nga noteri, pasi mënyra e likuidimit të çmimit provohet përmes një vërtetim pagese fletëdalje, të lëshuar prej palës shitëse, më datë 05.03.2008 kundrejt palës blerëse, pra nuk kemi të bëjmë me nje mandat të një insitiucioni financiar bankar me administrimin e të cilit nuk do të nevojitej të bëhej deklarimi në DPPPP nga noteri, në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar.

Lidhur me mënyrën e hartimit të akteve/veprimeve noteriale dhe detyrimin të noterit për përpilimin e tyre sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, konstatohen shkelje të ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, ligjit nr.7829/1994 "Për noterinë", i ndryshuar, (i shfuqizuar) dhe akteve nënligjore sa i përket dokumentacionit që duhet bashkëlidhur këtyre akteve, apo verifikimeve që duhen kryer nga noteri për hartimin e saktë të tyre (shkelje të cilat janë relatuar të gjitha në pikën XII të Raportit "Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit [REDAKTUAR]").

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr.8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 25, të gërmës "b", dhe "c", të pikës3, pikën 4 dhe 5 të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Dhënie e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit dhe gjobë në masën 300 000 lekë" noterit [REDAKTUAR], anëtar i Degës Vendore të Noterisë Korçë.
2. Detyrimin e noterit [REDAKTUAR] për marrjen e masave për regjistrimin në sistemin RNSH të të gjitha akteve/veprimeve noteriale të hartuara prej tij brenda 3 muajve nga njoftimi këtij urdhri, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 21.05.2014 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH) dhe Urdhrit nr. 88, datë 04.03.2013, të Ministrit të Drejtësisë "Për përdorimin e Regjistrit Elektronik Noterial Shqiptar (RNSH)", si dhe regjistrimin e të gjitha akteve/veprimeve noteriale që do të hartohen në vijimësi prej tij, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
3. Respektimin nga noteri të dispozitave ligjore në fuqi lidhur me vendosjen e taksës së pullës në akte/veprimet noteriale e hartuar prej tij, si dhe zbatimin me përpikmëri të dispozitave ligjore lidhur me të gjithë elementët dhe dokumentet shoqërues që duhet të ketë një akt/veprim noterial.
4. Noteri Josil Duro, të marrë të gjitha masat për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, që lidhen me ushtrimin e rregullt të veprimtarisë noteriale, sipas parashikimeve të Ligjit 110/2018 "Për noterinë" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.
5. Ky Urdhër t'i njoftohet menjëherë noterit [REDAKTUAR] si dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
6. Ndaj këtij urdhri, noteri mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
7. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Maliqja

